



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Kruje me 21.07.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME
ME
OBJEKT

LOTI NR.1- SHERBIME MEKANIKE PER MJETET MOTORIKE TE BASHKISE KRUJE.

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot me date 21.07.2026 ne Kruje prane Zyres se Prokurimeve , nga ana e Njesise se Prokurimit te caktuar me **urdherin nr.369 datë 20.07.2026** , te Titullarit te AK , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit e llojit “E Hapur e Thjeshtuar”, me te dhenat e objektit te prokurimit si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: Loti nr.1- Sherbime Mekanike per Mjetet Motorike te Bashkise Kruje.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Pjese kembimi per motore / (34312000-7).**

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,288,008 (pese milion e dyqind e tetedhjte e tete mije e tete) pa t.v.sh

BURIMI I FINANCIMIT:Te ardhurat e Bashkise Kruje dhe Transferta Specifike.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (ne vleren prej 2 % te fondit limit qe prokurohet)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1-a) Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2026 të lëshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë si dhe ushtron aktivitet sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2026 për secilin operator).*

Shenim-Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.10, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2026 të lëshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë si dhe ushtron aktivitet sipas QKB në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2026 për secilin operator).*

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, pika 5 në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i

ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a) Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 10 te ketyre DT (Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit) pikat,1;2.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”. Neni 83 i LPP përcakton se “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterave ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2023,2024,2025) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se **40 % e vleres e fondit limit te kontrates kontrates /lotit nr.1 (për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron).**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43**, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar edhe në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit të xhiros se kërkuar në kufirin e përcaktuar si më sipër konsiderohet tregues i rendesishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e nën kufirin e ulët monetar dhe iu jep mundësi tjetër të tjera dhe operatorëve ekonomik të vegjël dhe të mesëm të kenë akses në oferte.

Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatorët ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshtë në ekzekutimin apo realizimin e shërbimeve si më poshtë:

a)Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera/realizuara/ekzekutuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës **me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës** së përlogaritur

të kontratës/lotit nr.1 ose **(për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron)**, që prokurohet

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme të suksesshme , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik**, kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat**, kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e shërbimeve që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Vlera në kufirin e përcaktuar sipas VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë e Krujës), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Përqindja e përvojës së mëparshme të kërkuar (në raportin prej 20% të vlerës së fondit limit të kontratës) është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e

operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses.

3-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, staf inxhinierik si më poshtë:

- Nje inxhinier mekanik (1)

Per inxhinierin si me siper duhet te paraqesi kontratë pune te vlefshme(me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit te shërbimit për këtë objekt), diploma dhe librezë e punes.

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas **shtojcës nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës me kompetenca teknike për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimeve e pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e tyre dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafi teknik i kualifikuar është kërkuar ne raport me shërbimet qe kerkohen te realizohen te cilat jane te profilit mekanik. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës te afte profesionalisht per realizimin e objektit.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

4-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 3 (tre) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- (një) motorrist
- (një) xhenerik
- (nje) elektroauto

Për çdo profil punonjësi teknik si me sipër duhet të paraqitet, duhet të paraqitet si dokumentacion provues :

- kontrata individuale të punës e vlefshme për gjatë gjithë periudhës së afatit të realizimit të shërbimit ;
- një dokument të vlefshëm që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/ akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore

Shenim- Për të përmbushur këto kriter , në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas **shtojcës nr.10** , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar .

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen siç janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërve, etj është e nevojshme pajisja e një stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, verteturar kjo në bazë të legjislacionit të punës e të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar” për realizimin me sukses të kontratës. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

5-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Kandidati/ofertuesi duhet të disponojë makineritë dhe mjetet si vijon në pronesi ose me qera.

- a) pajisje për diagnostifikimin e defekteve të mjeteve (1)(një).
- b) pajisje urë ngritëse për automjetet, të paktën 1 (një) urë;
- c) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit (1)(një)(konvergjence).

Për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat provuese që vërtetojnë se, këto pajisje/mjete apo instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje sipas rastit , ku përfshihen (fatura tatimore të blerjes / akte zhdoganimit / kontrata qiraje e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontrata huapërdorje e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Legjislacionit përkatës në Republikën e Shqipërisë).

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, **sipas shtojcs nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku nje pjese e tyre mund te ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e prodhimit, makineritë, pajisjet, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njerëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është cmuar si e nevojshme zotërimi i makinerive të sipërmëndura nga OE, të domosdoshme për riparimin dhe mirembajtjen e automjeteve. Referuar natyrës së objektit të prokurimit riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pasja e nje sërë pajisjesh dhe makinerish. Duke u bazuar në numrin e automjeteve që disponon AK si dhe llojet e shërbimeve qe kërkohen te kryhen janë kërkuar të gjitha pajisjet e nevojshme.

Makinerite e pajisjet te cilat jane kerkuar si me siper nga ana e AK jane te nevojshme per te kryer proceset specifike te punes qe kerkon ekzekutimi me sukses i objektit te kontrates, pasi ne zerat respektiv te preventivit jane parashikuar procese te tilla qe kerkojne angazhimin e ketyre makinerive dhe pajisjeve.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoj(ne pronesi /me qera/huapërdorje), ambjent per ushtrimin te aktivitet te tij (lidhur me riparimin e mirmbajtjen e automjeteve), ne nje siperfaqe ku te perfshihen parkimi mjeteve + servisi + magazina pjeseve te kembimit + ambjente sherbimi te jashtme ne funksion te aktivitetit riparim te automjeteve).

Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese sipas rastit:

Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë, Çertifikata e pronësisë, e lëshuar nga autoriteti kompetent ose, kontrata e shitblerjes; ose, kontrata e dhurimit; ose, çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:Kontratën respektive (te vlefshme pergjate gjithe periudhes se afatit te realizimit te sherbimit) te siperfaqes qe zoteron.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:Kontratë qiraje(te vlefshme pergjate gjithë periudhes se afatit te realizimit te sherbimit) te siperfaqes qe zoteron.

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas **shtojcs nr.10** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM **Nr. 285, datë 19.5.2021** , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

Argumentimi-Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet te dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

b)-Ne rast difekti dhe pamundesie per te derguar mjetin për shërbim ne servis , operatori ekonomik duhet te ofroje per mjetet e Bashkise Kruje, sherbim rimorkimi apo karroatrece ne vendin ku ndodhet mjeti i dëmtuar (Deklarate nga administratori i shoqerise).

Argumentimi-Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet te dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike dhe Termat e Reference per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Sherbimeve dhe Investimeve Publike qe ka hartuar edhe elementet e tjere plotesues te dokumentacionit teknik te dokumentacionit perkates te ekzekutimit te kontrates duke qene elemente perberes te tij dhe qe jane administruar nga ana e Njesise se Prokurimit Publik me shkresen **nr. ____ prot date _____.2026**. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se mirmbajtjes dhe qarkullimit te mjeteve ne Republiken e Shqiperise

Me anë të kësaj procedure synohet mbajtja në gadishmëri teknike e automjeteve të transportit që ka në përdorim Bashkia Kruje dhe konkretisht në procedurë janë përfshirë gjithsej 17 mjete, të llojeve të ndryshme, sipas natyrës dhe funksionit specifik.

Zërat e shërbimeve janë hartuar bazuar në llojet e mjeteve në përdorim/shërbim të Bashkis Kruje referuar shërbimeve të parashikuara në një periudhë të afërt dhe mundësisë të defekteve të ndodhura nga përvioja e viteve të shkuara.

Referenca ligjore për specifikimet teknike: neni 36, i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Specifikimet Teknike dhe Termat e References janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

- Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e *artikujve objekti prokurimi* sipas listës së miratuar në preventivin përkatës është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Shërbimeve dhe Investimeve Publike **nr. ____ Prot, datë ____ .07.2026 (janë pjesë e shtojcës së DST respektive për këtë objekt prokurimi)**, duke identifikuar për çdo shërbim/pjesë këmimi specifikimin dhe karakteristikat përkatëse teknike të cilat plotësojnë nevojat respektive të Bashkisë Kruje në mirëmbajtjen *e mjeteve motorike që operon Bashkia Kruje në përbushjen e detyrimeve të saj në fushën e shërbimeve publike dhe infrastrukurës*, dhe më konkretisht në hartimin e tyre janë marrë në konsiderat kërkesat ligjore të normave përkatëse të Ligjit Nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.
- *Specifikimet teknike të përcaktuara për shërbimet objekt prokurimi janë hartuar në funksion të natyrës së përdorimit të tyre në instalime dhe pajisje industriale, ku kërkohet nivel i lartë sigurie, besueshmërie dhe qëndrueshmërie në punë. Këto materiale do të përdoren në kushte operative që kërkojnë pajisje të certifikuara, me parametra të qartë teknike dhe me performancë të garantuar.*
- Specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat e shërbimit që prokurohet, duke e përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë sipas objektit të prokurimit, të cilat krijojnë kushte për konkurim të paanshëm dhe të hapur për të gjithë operatorët ekonomik, duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar. Këto specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e konkurrencës dhe trajtim të barabartë nga marka të ndryshme të prodhimit të automjeteve për të gjithë Operatorët Ekonomikë e interesuar.

- Sa i perket standartit te tyre per cdo sherbim , ato jane hartuar duke marre ne konsiderate percaktimet respektive sipas artikujve dhe standartit te pranuar te tregut si dhe kerkesat perkatese te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".
- Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive. Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet "markë", "standart respektiv i referuar " do te pranohet termi "ose ekuivalent i tij/i saj".
- Argumentim: Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 "Specifikimet teknike" të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, e Nenit 41 pika 2, si edhe të Nenit 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.
- **Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te kerkesave specifike te nenit 34 te Ligjit nr 162/2020 'Per Prokurimin Publik' dhe nenit 76.1. te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".**Cmimet reference te preventivit per cdo ze jane marre referuar testimit te tregut per sherbimet e ngjashem komponente te preventivit te sherbimit..

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK